

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** - Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues - gjyqtarin Skender Çoçaj, me procesmbajtësen Birsen Kume - sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh. Sh. nga fshati G., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale posedimi paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KP- së, sipas aktakuzës së PTH në Prizren - PP.nr.98/2016 të datës 10.06.2016, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestarë, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Genc Nixha, të akuzuarit, si dhe mbrojtësit të tij av. E. G., me datë 07.10.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**Sh. Sh.**, nga i ati I. dhe e ëma H., e vajzërisë K., data e lindjes ... nga fshati G., Komuna e Suharekës, me vendqëndrim në G., Zvicër, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse pa autorizim ka poseduar substanca të shpallura me ligj si narkotik, substanca psikotrope ose substanca analoge, në atë mënyrë që me datë 12.04.2016 duke u kthyer nga Kuksi i Republikës së Shqipërisë, me automjetin e markës “Ford” tip “Mondeo” me targa xxx-KS-xxx, pronë e N. B., pronar i Biznesit Individual “R. C.”, me seli në Prizren, kur arrin në vendkalimin kufitar Shqipëri-Kosovë në fsh.Vërmicë, pas kontrollimit nga policia, në bagazhin e automjetit gjegjës kishte pasur të fshehur narkotikun e llojit “marihuanë” në peshë rreth 922.7 gram,

-Kësodore ka kryer veprën penale posedimi paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KP- së.

Andaj, Gjykata në bazë të neneve 6,7, 41,45,46,73,74 dhe 75 par.1 pika 1.3, 76 dhe nenin 275 par.1 të KP, të akuzuarin Sh. Sh. e

**G J Y K O N**

-Me dënim me gjobë në shumë prej 1.500 (njëmijepesëqind) euro, si dhe

-Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 12.04.2016 deri më datë 01.06.2016 dhe në arrest shtëpiak nga data 02.06.2016 deri më dt. 23.06.2016.

Në kuptim të nenit 47 të KP-së, me pëlqimin e të dënuarit Sh. Sh.

Dënimi me burgim prej 5 (pesë) muajve, i shqiptuar ndaj të akuzuarit, zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 8.000 (tetëmijë)euro.

Duke aplikuar dispozitat e nenit 80 të KP gjykata të akuzuarit i shqipton

### **DENIMIN UNIK**

Me gjobë në lartësi prej 9.500 (nëntëmijepesëqind) euro, në të cilën shumë do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim nga data 12.04.2016 e deri më datën 01.06.2016 si dhe për çdo ditë të kaluar në arrest shtëpiak të kaluar nga data 02.06.2016 deri më datën 23.06.2016 do ti llogaritet 20 (njëzet) euro ndërsa pjesën tjetër të mbetur të gjobës, i akuzuari është i obliguar ta paguajë në periudhë kohore prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën, dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet)euro të gjobës, do ti llogaritet një ditë burgim.

Në kuptim të nenit 275 paragrafi 3 substanca narkotike e llojit “marihuanë” në peshë prej 922.7 gram konfiskohet.

I akuzuari, Sh. Sh. obligohet që të paguajë shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor, në shumën prej 100 (njëqind) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur, pranë kësaj gjykate, aktakuzën PP.nr.98/2016 të datës 10.06.2016, kundër të akuzuarit Sh. Sh. nga fshati G., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale posedimi paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KP- së.

Prokuroria Themelore në Prizren Departamenti për Krime të Rënda me datën 07.10.2016 ka parashtruar marrëveshjen e korrigjuar mbi pranimin e fajësisë PP.nr.98/2016.

Gjykata gjatë shqyrtimit fillestarë, në pajtim me dispozitat e nenit 247 paragrafi 4 ka shqyrtuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ku ka dëgjuar të akuzuarin, mbrojtësin e tij si dhe prokurorin e shtetit lidhur me pretendimet e tyre sa i përket marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Sa i përket gjendjes faktike gjykata e ka vërtetuar ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e aktakuzës në kushtet dhe rrethanat ligjore të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit gjatë seancës ka deklaruar se prokuroria e shtetit ka arritur marrëveshje me të akuzuarin Sh. Sh. për veprën penale që i ngarkohet dhe është lidhur me vullnetin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij duke shtuar se marrëveshja është arritur në bazë të kushteve të parapara me ligj, ku i akuzuari para se të nënshkruaj marrëveshjen i ka bërë konsultimet paraprake me mbrojtësin e tij, dhe pasi që ishte bind se i akuzuari ka qenë shumë i sigurt se nuk ka pasur presione atëherë edhe është bërë nënshkrimi nga te dy palët.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. Sh., avokati E. G., propozon që të aprovohet marrëveshja si e tillë nga se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, i njëjti është i vetëdijshëm për pranimin e saj dhe dënimin e rekomanduar dhe kjo është e mbështetur me ligj dhe në provat të cilat i administron prokurori dhe gjykata.

I akuzuari Sh. Sh. në tërësi është pajtuar me deklaratën nga mbrojtësi i tij dhe ka propozuar që gjykata të aprovoj marrëveshja mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata pas dëgjimit të pikpamjeve të prokurorit të shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, lidhur me pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, konstatoi se i akuzuari Sh. Sh. e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. E. G., i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë të pranuar edhe nga i akuzuari, dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat që parashihen me dispozitat e nenit 253 par. 1 dhe 2 të KPP-së, për hedhjen e aktakuzës.

Gjatë seancës për caktimin e dënimit, prokurori i shtetit ka deklaruar se sa i përket dënimit qëndron pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. E. G., rreth dënimit i cili është propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ka deklaruar se qëndron pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, i akuzuari Sh. Sh. në tërësi është pajtuar me fjalët e mbrojtësit të tij.

Pas shpalljes së aktgjykimit i akuzuari Sh. Sh. është deklaruar se pajtohet që dënimi me burgimi prej 5 muajve i shqiptuar ndaj tij ti zëvendësohet me dënim me gjobë.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit, formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale, të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale-juridike të tij.

Me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij e në bazë të nenit 47 të KPK-së, gjykata ka vendosur që të akuzuarit, dënimin me burgim t'ia zëvendësojë me dënim me gjobë.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i dëgjoji deklaratat e të gjitha palëve, ka shqyrtuar dënimin e rekomanduar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjithashtu duke i marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të

parapara si në nenin 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, rrethanat personale të akuzuarit se është person familjar babë i tre fëmijëve, jeton dhe punon në botën e jashtme, gjendjen e tij të mirë ekonomike, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pendimin dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale. Gjykata në rastin konkret duke pas parasysh se i akuzuari ka pranuar fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe atë qysh në fazën e shqyrtimit fillestarë si dhe duke i marr parasysh rrethanat lehtësuese të lartpërmendura ka aplikuar dispozitat e nenin 75 par.1 pika 1.3 për zbutjen e dënimit. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPK, dhe se ky dënim, si i tillë, i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës, është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 451, paragrafi 1 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr. 157/16 me datë 07.10.2016**

**Procesmbajtësja**  
**Birsen Kume**

**Kryetari i trupit gjykues**  
**Skender Çoçaj**

**UDHËZIM JURIDIK:** Ndaj këtij aktgjykimi palët nuk kanë të drejtën e ankesës për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankesa për bazat tjera mund të ushtrohet, në afat prej 15 ditësh pas marrjes së të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.